



Pranimi / Dorezimi Prilipenja/Prilipenja Received/Delivery	02.06.2021	1	viti god. year
Organ /Njësia Organ /Jednitsa Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa e Prilip Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIMSHKIK	12781/2021		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.375/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.2163/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 29.04.2021, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.292/2019 të datës 24.05.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë: Këndi i Rugës “Bill Klinton dhe Dëshmorët e Kombit”-Zyra e ATK-së, Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “Masë Disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 01.06.2021 mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.292/2019 e datës 24.05.2019 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet** Vendimi me numër prot:29 i datës 26.04.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës si dhe Paralajmërimi (Qortim) me shkrim për shkelje disiplinore me numër protokolli:09-06-1381 e shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore me datë 22.03.2019 si dhe e njëjta të hiqet nga dosje e ankuesit.
- III. Obligohet** Drejtorit i Përgjithshëm i Administratës Tatimore, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditore nga dita e pranimit të tij.
- VI.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesit, sipas Akt Emërimit me nr.02/599/11 të datës 24.11.2016 i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës në pozitën “Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm”, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore me datë 22.03.2019 i ka shqiptuar masën disiplinore “Paralajmërim (Qortim) me shkrim për shkelje disiplinore me numër protokolli:09-06-1381.

Ankuesi i pakënaqur me masën disiplinore të shqiptuar me datë 22.03.2019 nga Drejtori i Përgjithshëm i

Administratës Tatimore të Kosovës, ka parashtruar ankesë me datë 05.04.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me datë 26.04.2019 ka nxjerr Vendimin Nr.prot:29 duke refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Ankuesi, kundër vendimit Nr.prot:29 të datës 26.04.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës me datë 24.05.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 27.05.2019 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Administratën Tatimore të Kosovës. Këshilli, me datë 03.06.2019 me numër protokollit 2552/2019 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 22.08.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 29.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2163/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 22.08.2019 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos për ankesën e ankuesit të datës 24.05.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me qëllim të vendosjes meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 25.04.2019 me numër protokollit 2436/2019 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së; Raportin e vizitave për bizneset dhe personat fizik që kanë ushtruar veprimtari ilegale për periudhën janar-mars 2019; Raportin për periudhën janar-dhjetor 2018; E-mailin e datës 29.01.2018 dërguar nga [] për [] me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 (tre) faqesh; E-mailin e datës 22.10.2018 dërguar nga [] për [] me korrespondencën e bashkangjitur prej 5 (pesë) faqesh; Listën e subjekteve të pagesave të tatimeve dhe akcizës për periudhën 2012-2018; E-mailin e datës 04.12.2017 dërguar nga [] për [] me korrespondencën e bashkangjitur prej 7 (shtatë) faqesh; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018 të datës 16.01.2019; Vendimin numër Nr.prot:29 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të datës 26.04.2019; Masën Disiplinore-Paralajmërimin (Qortim) me shkrim për shkelje disiplinore me numër protokollit:09-06.1381 të datës 22.03.2019; E-mailin e datës 22.03.2019 dërguar [] për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; Vërejtjen me shkrim të datës 13.05.2016; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 12.05.2016 me numër prot:15; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.05.2019; Përgjigjen në kërkesë të datës 03.06.2019; Akt emërimit e ankuesit të datës 24.11.2016 me numër prot:02/8599/11; Ankesën e ankuesit të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të datës 05.04.2019; E-mailin e datës 29.01.2018 dërguar nga [] për [] me korrespondencën e bashkangjitur prej 1 (nëntëmbëdhjetë) faqesh; E-mailin e datës 10.04.2019 dërguar nga [] për [] E-mailin e datës 10.04.2019 dërguar nga [] për ankuesin; Aktgjykimin me numër A.nr.2163/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 29.04.2021; Njoftimin e datës 22.08.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankuesi **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me numër prot:29 i datës 26.04.2019 përmes të cilit është lënë në fuqi masa disiplinore e shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore e datës 22.03.2019 është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe dispozitat e Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore me datë 22.03.2019 i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore “Paralajmërim (Qortim) me shkrim për shkelje disiplinore”.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 63 paragrafi 1 si dhe nenin 66 paragrafi 2 dhe 3 ku përcaktohet se: *“Nëpunësit civilë do t’u nënshtrohen masave disiplinore për shkelje të detyrës, që ka ndodhur si rezultat i fajit të tyre, sikur që është përcaktuar me këtë ligj”, “Shkeljet e detyrave të punës ndahen në: shkelje të lehta dhe shkelje të rënda – serioze, të cilat do të rregullohen me akt nënligjor. 3. Për shkelje të lehta shqiptohen masat disiplinore si në vijim: 3.1. vërejtje gojore; 3.2. vërejtje me shkrim që vendoset në dosjen personale të shërbyesit civil”* si dhe duke analizuar dispozitat e Rregullores nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 4 paragrafi 1, nenin 7 paragrafi 1 dhe me këtë rast Kolegji ka konstatuar se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore me datë 22.03.2019 e titulluar “Paralajmërim (Qortim) me shkrim për shkelje disiplinore” si e tillë nuk është e përcaktuar shprehimisht në asnjërën nga dispozitat e lartcekura dhe po ashtu, masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit e datës 22.03.2019 me numër 09-06-1381 e cila ka fuqinë e aktit administrativ dhe ka prodhuar efekte juridike ndaj palës respektivisht ankuesit është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe 1.4 ku përcaktohet se: *“1.3 Akti administrativ i shkruar përmban: pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin)”*; *“1.4 pjesën përmblylëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor...”* si dhe nenin 48 paragrafi 1 paragrafi 1.4 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *“1.Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsytetuesen e zbatueshme në rastin konkret”,* nenin 48 paragrafi 2 i të njëjtit ligj i cili përcakton se: *“Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”,* andaj pasi i mungon arsyetimi, baza ligjore e nxjerrjes së aktit si dhe këshilla juridike, masa disiplinore e titulluar “Paralajmërim (Qortim) me shkrim për shkelje disiplinore” e datës 22.03.2019 është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si e tillë nuk prodhon asnjë efekt juridik, ndërsa ankesa e ankuesit është e bazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër prot:29 të datës 26.04.2019, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative, Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike me rastin e refuzimit të ankesës së ankuesit të datës 05.04.2019 kundër shqiptimit të masës disiplinore nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore me datë 22.03.2019.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”,* dhe

me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: “Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me A.nr.375/2021

Flakron GASHI

Zyrtarë i Lartë për Bashkëpunim profesional

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Menaxherit të Personelit në Administratës Tatimore të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

